



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"UKSHIN HOTI"



UNIVERSITETI I SHKUPIT - UNIVERZITETI
"HAXHI ZEQA"



UNIVERSITETI "ISA BOLETINI"
MITROVICË



UNIVERSITETI "KADRI ZEQA"
GJAKOVË



Universiteti - University
FEHMI AGANI
GJAKOVË



UNIVERSITETI
ISHIKNCAVI I APIKUARA
SHKUPI

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës

25.09.2021

Mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/37 të datës 24.9.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, respektivisht pika 20, Konferenca e Rektorëve, pas diskutimeve, në takimin e mbajtur më 25.09.2021:

Rekomandon

1. Të gjitha aktivitetet e pezulluara, si pasojë e vendimit të Qeverisë 01/35 të datës 12.9.2021 (provimet e mbetura të afatit të shtatorit si dhe provimet pranuese për pranimin e studentëve të rinj), do të fillojnë të zhvillohen duke filluar nga data 27 shtator 2021, sipas orareve të universiteteve, respektivisht njëjësive akademike, më së largu deri më 15 tetor.
2. Si pasojë e pezullimit dyjavor të aktiviteteve mësimore, Konferenca e Rektorëve rekomandon që procesi mësimor – ligjëratat të fillojnë më 15 tetor 2021 me prezencë fizike.
3. Proces i mësimor, respektivisht ligjëratat, do të zhvillohen duke respektuar udhëzuesit përkatës, me kusht që numri i studentëve në një klasë mundëson në mënyrë rigoroz mbajtjen e distancës prej 1.5 metra në mes të personave.
4. Në rastet e caktuara, dhe për të respektuar distancën prej 1.5 metra, ligjëratat do të organizohen në dy grupe të studentëve: Orët e mësimit në dy grupe – ora e parë 40 minuta grupi i parë i studentëve; ora e dytë 40 minuta grupi i dytë i studentëve. Në mes të dy orëve do të mundësohen 10 minuta për ndërrimin e studentëve.
5. Në raste tjera dhe varësisht edhe vendimeve të Qeverisë do të mundësohen edhe orët hibride dhe online.
6. Lidhur me këtë rekomandim, Senatet e Universiteteve Publike nxjerrin vendime.
7. Rekomandimi iu dërgohet të gjitha universiteteve publike.

Arsyetim

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/37 i datës 24.9.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, respektivisht pika 20, ka përcaktuar se procesi mësimor, respektivisht ligjëratat do të zhvillohen duke respektuar udhëzuesit përkatës, me kusht që numri i studentëve në një klasë mundëson në mënyrë rigoroz mbajtjen e distancës prej 1.5 metra në mes të personave. Për shkak të pezullimit dyjavor të aktiviteteve mësimore, Konferenca e Rektorëve rekomandon që procesi mësimor – ligjëratat do të fillojnë më 15 tetor.

Prof. Dr. Alush Musaj, rektor i UIBM

Kryesues i Konferencës së Rektorëve